




NATASHA KAZMAJ (KALEMI)


|       |       |       |      |       |       |      |      |      |      |      |
|-------|-------|-------|------|-------|-------|------|------|------|------|------|
| 960   | 458   | 411   | 91   | 523   | 437   | 739  | 221  | 384  | 461  | 115  |
| teste | Në %  | Në %  | Në % | Në %  | Në %  | Në % | Në % | Në % | Në % | Në % |
|       | 47.7% | 42.8% | 9.5% | 54.5% | 45.5% | 77%  | 23%  | 40%  | 48%  | 12 % |

Le të shohim në grafikë këto vlerësime për të gjykuar më qartë rreth tyre.


Vlerësimi për shtjellimin e idesë.




Vlerësimi për strukturën



Vlerësimi për stilin



Vlerësimi për saktësinë gjuhësore



Nëse do të ndalemi në zbërthimin e këtyre grafikëve, konkretisht grafikut të parë, vëmë re se nxënësit në përgjithësi e kanë kuptuar temën dhe dinë të japin një ide rreth saj, edhe kur nuk e kristalizojnë mirë atë. Por nuk është pozitiv fakti që një pjesë e konsiderueshme, afërsisht gjysma, nuk kristalizojnë qartë një ide për një temë të dhënë në një ese përshkruese. Në përgjithësi kushdo që ka shkruar diçka rreth temës është vlerësuar minimalisht me 1 pikë, ndaj ata që janë vlerësuar me 0 pikë ose nuk kanë shkruar asgjë rreth temës edhe kur kanë shkruar diçka, pra kanë trajtuar diçka që nuk lidhet me të duke lënë një pikëpyetje se nuk e kanë kuptuar temën dhe atë që ajo kërkon, duke na bërë të mendojmë për një problem

## Probleme gjuhësore në të shkruarin e nxënësve

---

shumë të madh që ne vazhdimisht kemi në testime të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, rreth të kuptuarit të një fraze, kërkesë apo teksti.

Ndërsa sipas grafikut të dytë, përsa i përket numrit të vogël të nxënësve që janë vlerësuar me 0 pikë në strukturë, kjo duket se është vetëm për rastet kur nxënësit nuk respektojnë asnjë lloj ndarjeje në paragrafë, nga hyrja në zhvillim e nga zhvillimi në mbyllje.

Këtu vihen re dhe probleme të tjera të elementeve të strukturës që do të trajtohen më poshtë, si ajo që edhe pse ka ndarje në paragrafë mungon një hyrje e mirëfilltë apo ndonëse ekziston si përmbajtje hyrja apo mbyllja, ato nuk ndahen në paragrafë (kryeradhë) gjatë të shkruarit.

▪ Më e diskutueshmja rubrikë e vlerësimit është ajo e stilit. Kjo sepse vlerësimi afërsisht 50 me 50 në rubrikën e idesë dhe strukturës shkon deri-diku në progresion të njëjtë ose në raport të njëjtë me vlerësimin e stilit. Se çfarë është e diskutueshme në këtë pikë do e shohim më poshtë.

▪ Nga ajo që shohim në grafik rreth vlerësimit të drejtshkrimit, duket i kënaqshëm fakti që vetëm 12% e nxënësve kanë marrë vlerësimin 0 në këtë rubrikë. Ky vlerësim duket se bie ndesh me problemin që ne kemi sot sepse një pjesë e madhe e nxënësve kanë probleme me drejtshkrimin por ka dhe një anashkalim të disa gabimeve drejtshkrimore që nuk janë të përsëritura ose nëse gabimi qëndron në -ë fundore të patheksuar ose paratheksore dhe nuk është e përsëritur ajo ka vetëm një pikë ose nxënësi nuk është penalizuar për këtë.

Këtu dhe në të tëra vlerësimet e grafikëve të mësipërm nuk janë marrë parasysh ato teste në të cilat nuk është zhvilluar fare kjo rubrikë dhe që normalisht kanë marrë 0 pikë në të tëra hallkat e vlerësimit të esesë dhe nga sa shihet janë marrë në analizë vetëm ato teste ku kjo rubrikë është trajtuar sado pak.

Për të bërë një vlerësim sa më afër së vërtetës në lidhje me rubrikën e të shkruarit, fillimisht u bëmë tri pyetje që lidhen me qëllimin e studimit disa prej mësuesve të cilët u morën me vlerësimin e testeve të liritimit të klasave të nënta. Pyetjet u bënë në lidhje me të kuptuarit e temës, por dhe punën e përgjithshme të nxënësve në këtë rubrikë të testit dhe për llojet e gabimeve drejtshkrimore, fonetike apo morfologjike.

Pyetjet që u drejtuam mësuesve janë këto:

- Ç'mendim keni për temën dhe formulimin e pyetjes në rubrikën "të shkruajmë" në provimin e liritimit qershor 2014?
- Cilat janë problemet që dalin në mënyrën e të shkruarit të nxënësve në ide, strukturë e stil?
- Cilat janë gabimet më të shpeshta drejtshkrimore që gjetët te nxënësit në këtë ese?

Në lidhje me formulimin e pyetjes u dhanë këto mendime:

❖ Pyetja nuk e theksonte faktin që duhej një ese, ndonëse në tabelën e vlerësimit nga elementet që vlerësohen kemi të bëjmë me një ese. Por nxënësi nuk është gjithmonë aq i vëmendshëm sa të konstatojë dhe pa ua kërkuar e specifikuar në pyetje.

Kjo mund të jetë vetëm një nga arsyet në një masë të vogël që nxënësi nuk e ka vlerësuar si të rëndësishme strukturën për ta paraqitur esenë minimalisht në tre paragrafë, sepse në disa raste hyrja, zhvillimi apo mbyllja ekziston por mungesa e ndarjes në paragrafë e bën atë të shkrirë me zhvillimin. Megjithatë në tabelën e vlerësimit është specifikuar qartë pikëzimi për një ese.

❖ Faktin që paragrafët hyrje, zhvillim, mbyllje, nuk janë paraqitur me kryeradhë për të bërë të dallueshme të paktën këto tri elemente kanë bërë që një pjesë e punimeve të mos jenë vlerësuar në rubrikën e strukturës sepse e kanë bërë krijimin në një paragraf të vetëm, por dhe aty ku është respektuar paragrafi për hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen ka zgjatje të panevojshme që nuk i përkasin hyrjes ose mbylljes duke cinguar dukshëm zhvillimin dhe mos dalluar si duhet elementet e strukturës nga njëra tjetra. Një problem tjetër që vihet re është se ndonëse ekzistojnë paragrafë nga një element i strukturës në tjetrin herë pas here ata janë të palidhur kuptimisht me njëri-tjetrin, duke bërë kështu shkopitje të vazhdimësisë së kuptimit tërësor të përmbajtjes së temës.

Një problem tjetër që u konstatua gjatë vlerësimit të testeve dhe që nuk i jep nxënësit vlerësimin maksimal në strukturë, është që një pjesë e konsiderueshme e krijimeve janë pa mbyllje. Edhe kur kjo mbyllje është e pranishme në ndarje paragrafi ajo ka vetëm një fjali dhe jo një paragraf, pa iu përmbajtur aspak rregullit të shkrimit të një mbylljeje me një ide të kristalizuar e të përmbledhur rreth asaj që u tha në paragrafët e tjerë. Kështu në klasën e shtatë kur nxënësi merr njohuritë e para teorike rreth shkrimit të esesë mëson "...mbyllja jepet përmbledhtas në trajtën e opinionit tuaj rreth temës ose faktit që trajtuat" (shih "Gjuha shqipe" 7, Albas, Tiranë, 2013, f. 77).

Në fakt mbylljet jo rrallë janë të shkurtra dhe të paplota duke u përmbledhur me fjali të tipit: "...Kjo do ishte piktura ime."

"...kjo është arsyeja e ilustrimit të kësaj vepre" apo

"...Edhe mua më pëlqen kjo pikturë"

❖ Përsa i përket zhvillimit duke lënë në një anë faktin që pak ese nuk i kishin tre paragrafë, problemet më të mëdha ishin jo me strukturën brenda për brenda zhvillimit, sesa me përmbajtjen dhe kjo sidomos në kristalizimin e asaj që kërkonte tema.

Kështu gjejmë detaje të shumta që nxënësit duan t'i vizatojnë në mur, dhe jo rrallë një mungesë e përcaktimit qartë të objektit të përshkrimit, por dhe kur jepet objekti i përshkrimit asnjëri prej tyre nuk ishte i përshkruar hollësisht, gjë e cila theksohej në formulimin e temës.

Edhe kur ky përshkrim ekziston, vërehet një mungesë e theksuar fjalësh që e plotësojnë përshkrimin apo imazhin e asaj që duhet të përshkruhet, si mungesa mbiemrash (elementet kryesore në përshkrimin e një objekti të palëvizshëm së bashku me emrat) dhe larmishmërisë të tyre. Pra jo vetëm në sasi kanë një varfëri fjalësh por dhe në cilësi, sepse dhe ato pak mbiemra që përdoren nuk krijojnë asnjë lloj emocioni tek ai që e lexon apo imazhi të qartë të asaj që do pikturojnë.

Këtë po e ilustrojmë me disa detaje dhe fjali të cilat mbeten të cinguar në ide e në fjalë, dhe shumë të varfra në përmbajtje.

## Probleme gjuhësore në të shkruarin e nxënësve

---

...idhullin tim dajën. Ka një shpirt fisnik, më bën të qesh pa fund dhe në çaste të trishtuara.

...portretin e familjes sime, gjëja më e shtrenjtë.

...peizazh pamje nga bregdeti për të kujtuar një ambient ndryshe.

...një plazh me ujë të kristaltë.

...kafshët.

...natyrën e qetë.

...një dhomë ëndrrash.

...kalanë e Beratit.

...pamje nga deti.

...ujëvarë e rrethuar nga pemë.

Personazhet e dashur të filmave vizatimorë.

...lojtarët e zemrës sime Barcelonës, si Mesi, Pike, Valdes, Sançes etj. sepse pasioni im është futbolli.

...unë me vëllain.

...familjen time e cila është motivi im.

...portretin tim.

Secila prej tyre përbën përshkrimin e një pikturë që ata duan të vizatojnë dhe shihet ndonëse fjalët janë zgjedhur me kujdes ato janë të pakta dhe nuk japin një pamje të plotë të asaj që do përshkruhet. Kryesisht këto përshkrime mbeten këtu.

Nuk mund të mohojmë që gjetëm dhe përshkrime shumë të mira si:

...një fshat të vogël piktoresk me qiell të kaltër, diell të magjishëm, ujë të kulluar, shtëpi me çati në formë trekëndore, rrugica të vogla etj...

Si do ta shohim dhe në disa shembuj më poshtë do kuptojmë që nxënësit nga dëshira për t'u shprehur në një stil letrar dhe regjistër të ngritur, një pjesë e fjalëve ose e kanë përzgjedhur gabim ose nuk japin atë që kërkon tema. Kjo duket dhe në shembullin e mëposhtëm, ku përveçse fjalët janë përzgjedhur jashtë kontekstit, pra kuptimi i tyre leksikor dhe lidhja nuk shkon në vazhdimësinë e fjalëve të tjera lidhur me të dhe kur nga ana gramatikore duken në rregull. Ky përdorim fjalësh ka ndikuar në ndërtim fjalësh deri-diku të pakuptimta dhe të paqarta si nga ana strukturore dhe nga ana logjike ose krejt abstrakte pa krijuar asnjë lloj imazhi.

...tablo që shpreh karakterin tim, jo e deshifrueshme si vetë bota ime e brendshme

...pikturimi i një fotoje me mamanë time të shtrenjtë, ngjyra të theksuara që tregojnë dashuri, adhurim, respekt dhe mirënjohje.

...piktura e ka kuptimin të fshehur. Njeriu shpreh ndjenjat, emocionet, fantazitë e tij, jep pak nga vetja. Unë do të vizatoj një luan.

Dhe kështu një pjesë e përshkrimeve mbylleshin dhe ishin mjaft të reduktuara.

Padyshim kishte dhe shkrime shumë të thjeshta pa ndonjë fjalor të ngarkuar që i përmbaheshin kërkesës.

❖ U vu re se kanë një vlerësim të mirë në stil, por lidhur me këtë mund të themi dhe që koncepti i stilit mund të jetë i paqartë për atë që kanë bërë vlerësimin e shkrimeve ose nuk e kanë marrë në konsideratë konceptin e mirëfilltë të stilit në të shkruar. Dhe në fakt koncepti i stilit është shumë më i gjerë nga sa ne kërkojmë.

Sipas fjalorit të shqipes kemi këtë kuptim të termit “stil” .... gjuh. *Zgjedhja dhe ndërthurja e mjeteve të gjuhës (kryesisht e mjeteve leksikore e sintaksore) në përputhje me kërkesat e një fushe të veprimtarisë, me përmbajtjen ose me metodën artistike dhe me qëllimet e shkrimtarit; shtresimi i mjeteve të gjuhës sipas funksioneve që kryejnë në ligjërim. Stilet gjuhësore (e gjuhës). Stilet funksionale. Stil bisedor (libror, zyrtar, shkencor, publicistik). Stil i lartë. Sistemi i stileve. Stili i plotë i shqiptimit.* (shih, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980, f. 1113).

Kështu vlerësohen pozitivisht për nga stili ato shkrime që kanë jo vetëm fjalë të përzgjedhura me kujdes, por dhe fjali të ndërtuara mirë me zgjatjen e kërkuar, lidhjen logjike mes gjymtyrëve e vetë fjalive si dhe harmonizimit të mendimeve në tekst. Duke iu referuar tekstit mësimor të nxënësit dhe aktualisht tekstit të vetëm në duart e nxënësve vërejmë në temën “Përdorimi i fjalive të përbëra” këtë shënim mbi përdorimin e tyre;

“...Zakonisht në përshkrimin e natyrës e të mjedisit ku veprojnë personazhet, përdoren fjali të thjeshta e të përbëra me pak pjesë...” (shih “Gjuha shqipe” 9, Albas 2013).

Nga ky këndvështrim vërehet një shkallëzim i tejzgjatur i fjalive me pjesë të bashkërenditura të shumta, të zgajtura në mënyrë të panevojshme, duke humbur qëllimin e mirëfilltë dhe kuptimin për të cilin janë ndërtuar dhe që duhet të shprehin. Shembull:

*“Unë do të vizatoja detin me shkëmbinj të jugut malet që i rrethojnë, anijet që ankorohen me mallra e pasagjerë, plazhet e bukura ku pasagjerët kalojnë verën, përdënimin e diellit dhe lindjen e tij, do të vizatoja gjithçka që më sheh syri në Vlorë si në dimër edhe në verë edhe pse gjatë dimrit ajo është pa shumë jetë dhe në verë gumëzhin nga zhurma e turistëve të shumtë nga vendi dhe Kosova.”*

Në fakt vlerësimi i stilit më duket pak fiktiv dhe nuk është parë i shkëputur nga ideja, struktura dhe drejtshkrimi, ndaj nuk mund të themi se vërtet në këtë pikë nxënësit janë vlerësuar realisht.

Si ta kuptojmë këtë?

Në vlerësimin e stilit tek- tuk vërehej dhe fakti që ndonëse nxënësi ka shkruar qartë, me fjali të lidhura mirë, për arsyen që ka qenë jashtë kontekstit të temës është vlerësuar me 0 pikë në stil duke iu referuar kështu vlerësimit të rubrikës së idesë.

Po cilat janë problemet e mirëfillta gjuhësore që gjatë të shkruarit nxënësit lenë për të dëshiruar në rubrikën e stilit.

Kështu duke qenë se stili nuk përfshin vetëm ato që thamë më sipër dhe jo vetëm në këto shkrime, por në përgjithësi nxënësit kanë probleme me stilin si rrjedhshmëri të shprehuri mund të marrim këta shembuj për të konkretizuar ato që thamë.

Atëherë në lëndën e gjuhës, në disiplinën e sintaksës dhe të morfologjisë nxënësi mëson rregullat e shmangies nga struktura klasike. Kuptohet duke mos e kuptuar stilin vetëm si përdorimi i një gjuhe të caktuar, pra fjalori të pasur në varësi të asaj që shkruan dhe të atij që i drejtohet, fjali të lidhura me kujdes nga

## Probleme gjuhësore në të shkruarin e nxënësve

ana drejtshkrimore dhe me gjatësinë e duhur, por dhe si shmangie nga rregullat pa i deformuar ato vërejmë këto probleme me nxënësit.

- Kështu ata në morfologji kanë mësuar se përemri vetor zëvendëson shumë mirë emrin sidomos kur ai është përmendur më pare, pra për të evituar përsëritjet e panevojshme.. “.. *Veta e tretë zakonisht përdoret për të mos përsëritur një emër që është përdorur më përpara*” (shih “Gjuha shqipe” 5, f. 124, dhe “Gjuha shqipe” 6, f. 222, “Albas”, Tiranë, 2013).

Dhe jo rrallë fjalitë e nxënësve fillojnë me të njëjtën fjalë, kryefjalë pa përdorur funksionin e përemrave vetorë, ose në mënyrë të vazhdueshme përsëritet e njëjta fjalë në çdo fjali por dhe dy herë brenda fjalisë. Për shembull:

*“Mua më pëlqen të vizatoj pyllin. Në pyll ka drurë të lartë e lule që nuk gjenden askund tjetër. Pylli është foleja e kafshëve të egra dhe në pyll mund të gjesh shumë nga këto. Pyjet tona kanë larmishmëri kafshësh e zogjsh dhe këngët e tyre e mbushin pyllin me jetë.”*

- Gjithashtu në sintaksë kanë mësuar se fjalët kanë një rend të caktuar në fjali por jo të ngulitur. Ky rend mund të prishet, ku kryefjala të dalë në fund dhe një pjesë e gjymtyrëve para saj kur duam të theksojmë ndonjë prej tyre. Po kështu dhe pjesët e nënrenditura në një periudhë ose fjali të përbërë vendosen para kryesores kur duam t’i theksojmë ato. Dhe pikërisht këto detaje që përsëriten mjaftueshëm në orët e njohurive gjuhësore nuk gjejnë zbatim për të pasur një stil sa më të përsosur në shkrimet e tyre. “...por kryefjala mund të qëndrojnë dhe pas kallëzuesit, në këtë rast ajo theksohet më shumë (Gjuha shqipe” 6, Albas”, Tiranë, 2013, f. 266.)

- Mungesa e presjes ose vendosja gabim e saj më shumë se një problem drejtshkrimor, përbën një problem stilistik sepse nuk kryen funksionin e shkëputjes së mendimeve e ideve.

Për shembull; “...*Tek muri i dhomës time unë do të pikturoja një pyll të madh dhe të bukur me kafshë të egra një gjelbërim të bukur disa shtëpi të vogla një ajër i pastër fëmijë duke luajtur pemë të bukura një gjuetar duke gjuajtur për kafshë për fllanxa për derra etj.*” Përveç gabimeve në drejtshkrim e leksik, të cilat janë dhënë me italik, vërehet mungesë totale e presjes në të gjithë paragrafin.

- ❖ Një nga rubrikat që ka pasur vlerësim mjaft të diskutueshëm është dhe ajo e drejtshkrimit.

Në fakt nëse do tregoheshim shumë rigorozë në këtë pikë mund të themi se ky vlerësim mund të ishte më i ulët. Vërehet një ekuilibrim i vlerësimit ku afërsisht gjysma e tyre kanë marrë një pikë në këtë rubrikë, 40% janë vlerësuar me 2 pikë dhe vetëm 12% e tyre janë vlerësuar me 0 pikë. Ndërkohë vërejmë që problemet janë të shumta dhe ato më tipiket e më të shpeshtat janë renditur më poshtë. Kështu nëse ndalemi në faktin që gabimet drejtshkrimore duhen minimizuar por jo penalizuar deri në atë pikë sa të dobësojnë vlerësimin e idesë e të stilit do vëmë gishtin në ato gabime që ndikojnë vërtet në një shkrim, në idenë e tij dhe sidomos stilin.

- Nuk po i rikthehem përdorimit të presjes por vërtet që duhet parë përdorimi i saj jo sipas rregullave strikte të drejtshkrimit por në funksion të asaj që thuhet, theksohet, veçohet etj. Ajo merr një vlerë të veçantë dhe nëse nuk penalizohet në rubrikën e drejtshkrimit ajo mund të penalizojë nxënësin në rubrikën e stilit dhe idesë duke krijuar mangësi e paqartësi në to.

- Një problem përbën ndarja e fjalëve në fund të rreshtit që megjithëse mësohet që në klasën e parë me ndarjen e fjalëve në rrokje, shohim probleme në ndarjen e zanoreve apo të bashkëtingëlloreve më vete në rreshtin pasardhës ose paraardhës. P.sh.: fjalët përs-hkrim, apo p-ikturë etj.

- Një problem që haset rëndom pothuajse te një masë e konsiderueshme nxënësish është përdorimi i zanores -ë-. Këtu shumë herë i është vënë theksi mungesës së zanores -ë- së patheksuar kjo sidomos në fund të fjalës p.sh.

Ësht..., i vërtet..., kam marr..., fjal...

Një problem tjetër vërehet me zhvendosjen e kësaj zanoreje në pozicione të tjera të panevojshme ose sidomos shtimi i kësaj zanoreje në mënyrë të panevojshme në fjalë të tipit: barë, sotë, bëjë, etj.

- Mungesa e -ë- pastheksore në trup të fjalës p.sh.: hap(ë)sirës, prind(ë)rit etj.

- Përshtatja e gabuar e nyjes me përemrin lidhor gjatë vendosjes së tij në rasën e duhur. “Unë do të doja të pikturoja një ambient të pastër, *të cilin* do të përdorja shumë ngjyra.”

- Përdorimi i gabuar i pjesëzës -të- në lidhje me pjesëzën mohuese (mos) “...mos të vizatoj” në vend “... të mos vizatoj”.

- Përdorimi i bashkëtingëllores -j- në vend të zanores i. “djell” në vend të “diell” apo “t’ja” në vend të “t’ia”

- Përdorimi i gabuar i përemrave pronorë ‘joti’ në vend të ‘yti’ apo përshtatja sipas gjinisë; “dhomës time” në vend të “dhomës sime” ose “gustos time” në vend të “gustos sime”

- Rrudhja e grupit të zanoreve në një zanore të vetme ‘rruza’ në vend të ‘rruaza’.

- E ardhmja shkruhet pa pjesëzën ‘të’; p.sh. do pikturoj, do vizatoja etj.

- Vendosja e thonjzave vend e pavend si p.sh. në emërtimin e qyteteve

- Mungesa e apostrofit në trajtat e shkurtra të bashkuara ose të shkurtra me pjesëzën *të* të lidhore “ti vizatoja” në vend të “t’i vizatoja”

- Ka dhe shumë gabime të tjera drejtshkrimore, por këto janë më të rëndomtë dhe që nuk janë një problem i izoluar por ndikojnë në strukturë, ide e sidomos në stil pjesa më e madhe e tyre etj.

Për konkluzionet e mësipërme u bazuam në shënimet e disa mësuesëve që u morën me korrigjimin e testeve.

Duke bërë krahasimin e vlerësimit të nxënësve në rubrikën e të lexuarit dhe njohurive gjuhësore me rubrikën e të shkruarit, ky vlerësim shkon paralel, pra nxënësit që i janë përgjigjur shumë mirë rubrikave të të lexuarit dhe njohurive gjuhësore janë paraqitur mirë dhe në rubrikën e të shkruarit. Por ka dhe raste ku, edhe pse në rubrikën e të lexuarit dhe njohurive gjuhësore nxënësit janë paraqitur

## Probleme gjuhësore në të shkruarin e nxënësve

---

relativisht mirë, ata kanë pasur probleme në rubrikën e të shkruarit ose nuk e kanë zhvilluar atë. Ky ndryshim lidhet me një sërë faktorësh si: mënyra rigoroze ose jo e zhvillimit të testit apo mosthëllimi i nxënësve në këtë rubrikë në përfundim të testit. Fakt mbetet që kjo është rubrika më e diskutueshme dhe me më shumë probleme për nxënësit e nivelit parauniversitar.

### KONKLUZIONE

1. Nxënësit kanë probleme me specifikimin e kërkesës së llojit të esesë përmes temës
2. Nuk përshtatin si duhet mënyrën e shkrimit të esesë me llojin e saj.
3. Nuk zbatojnë ndarjen minimale të shkrimit në paragrafë
4. Nuk dinë të ndërtojnë paragrafë të strukturuar qartë dhe me ide të konsoliduara në vazhdimësi
5. Kanë problem me zbatimin e strukturës dhe zgjatjen e duhur të secilit element të strukturës
6. Bëjnë gabime të shumta drejtshkrimore të tipit fonetik, sidomos me *ë* fundore, morfologjik, me përshtatjen e përemrave pronorë me emrin dhe sintaksore që nga ndërtimi e lidhja mes fjalive e deri në ndërtimin e paragrafëve

### REKOMANDIME

1. Të formulohen tipe të ndryshme pyetjesh - ese dhe të qarta jo vetëm në formulim për atë që kërkohet kuptimisht por dhe për llojin e esesë që kërkohet.
2. Nxënësit duhet të njihen me llojet e ndryshme të eseve dhe pyetjeve ese për të perceptuar qartë atë që kërkohet tema dhe për të arritur më qartë atje ku duam.
3. Të punohet për pasurimin e fjalorit të nxënësve me të gjitha pjesët e ligjëratës dhe përdorimin e tyre jo vetëm të saktë nga ana drejtshkrimore por dhe përdorimin sa më të larmishëm e me stil të fjalës.
4. Të punohet gradualisht për njohjen dhe më pas zbatimin e stilit të ndryshme të eseve.
5. Përdorimi i drejtë i gjuhës në përgjithësi dhe gramatika në veçanti të vihen në zbatim të të shkruarit të nxënësve jo vetëm për saktësinë drejtshkrimore por dhe për përmirësimin e stilit sipas llojit të esesë.

### LITERATURA

- Programet e arsimit bazë <http://www.izha.edu.al/programet/klasa9/gjuha9.pdf>  
R. Vrapit, *Si të hartojmë dhe vlerësojmë ese*, Kurrikula dhe shkolla 2, 2002, f. 172.  
*Gjuha shqipe* 5,6,7,8,9, Albas, Tiranë 2013.  
*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 1113.  
*Provimi i Lirimit*, sesioni I, Qershor 2015 (Materiale të hulumtuara, të pabotuara.).

